



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni vjeshtor

Seancë plenare e Kuvendit

P- 038

Prishtinë, më 3 dhe 10 tetor 2008, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, sala e seancave plenare.

PROCESVERBAL

**I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË MBAJTUR
MË 3 DHE 10 TETOR 2008**

Seancën e kryesoi **Jakup Krasniqi**, Kryetar i Kuvendit, kurse i ndihmoi **Ibrahim Gashi**, anëtar i Kryesisë.

Kryetari konstatoi se në seancë janë të pranishëm 96 deputetë dhe e deklaroi të hapur punën e saj.

Kryetari i njoftoi deputetët se Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me grupet parlamentare, në pajtim me rregullat 6.2 dhe 23 të Rregullores së Punës së Kuvendit, ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka paraqitur rendin e ditës për seancën e sotme plenare.

Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë

R e n d d i t e:

1. Miratimi i procesverbaleve të seancave plenare të mbajtura më 19 dhe 25 shtator 2008,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Shqyrtimi i Mocionit për procedimin e ligjeve të pashpallura,
4. Shqyrtimi i Rekomandimit për amendamentimin e Ligjit nr. 02/L-119 për Letërnjoftimin
5. Shqyrtimi i Rekomandimit për amendamentimin e ndryshimit dhe plotësimit të Ligjit nr.

- 2003/9 për kooperativat e bujqve,
6. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor lidhur me gjendjen në parkun nacional “ Malet e Sharrit” dhe në “Fshatin Turistik” në Prevallë,
 7. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor lidhur me gjendjen në pyjet e Kosovës.

1. Miratimi i procesverbaleve të seancave të mbajtura më 19 dhe 25 shtator

Kuvendi miratoi procesverbalet e seancave plenare, të mbajtura më 19 dhe 25 shtator 2008.

2. Koha për pyetje parlamentare

Për shkak të pyetjeve të shumta që ishin parashtruar për këtë seancë, Kryetari propozoi që deputetët fillimisht të parashtrojnë vetëm nga një pyetje për Kryeministrin ose për ministrat e Qeverisë së Kosovës, pastaj nëse premtom koha, mund t’i parashtrojnë edhe pyetje të tjera.

Kuvendi miratoi propozimin e Kryetarit.

Deputetja **Gjylnaze Syla** i parashtroi pyetje Kryeministrit të Kosovës lidhur me atë se a ka hartuar Qeveria e Kosovës strategji kombëtare kundër varfërisë?

Kryeministri **Hashim Thaçi** iu përgjigj pyetjes së deputetes **Syla**.

Deputetja **Synavere Rysha** i parashtroi pyetje ministrit të Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë lidhur me mungesën e inventarit shkollor në Gjimnazin “Kuvendi i Arbërit” në Ferizaj.

Ministri **Enver Hoxhaj** iu përgjigj pyetjes së deputetes **Rysha**.

Deputeti **Zafir Brisha** i parashtroi pyetje ministrit të Mjedisit dhe të Planifikimit Hapësinor lidhur me shkatërrimin masiv të tokës bujqësore dhe nxjerrjen e zhavorrit nga ndërmarrjet e pa licencuara.

Ministri **Mahir Yagcilar** iu përgjigj pyetjes së deputetit **Berisha**.

Deputeti **Arsim Rexhepi** i parashtroi pyetje Kryeministrit të Kosovës lidhur me përmbushjen e detyrimeve nga kontratat për privatizimin e ndërmarrjeve publike.

Ministri **Ahmet Shala** iu përgjigj pyetjes së deputetit **Rexhepi**.

Deputeti **Driton Tali** i parashtroi pyetje ministrit të Ekonomisë dhe të Financave lidhur me zvogëlimin e pagave dhe të benifiteve për menaxherët e KEK-ut, të PTK-së dhe Aeroportit.

Ministri **Ahmet Shala** iu përgjigj pyetjes së deputetit **Tali**.

Deputetja **Nurishahe Hulaj** i parashtroi pyetje ministrit të Shëndetësisë lidhur me blerjen e aparaturës përkatëse nga ana e kësaj ministrie për matjen e sasisë së katranit, të nikotinës dhe të monoksidit të karbonit në cigare të duhanit.

Ministri **Alush Gashi** iu përgjigj pyetjes së deputetes **Hulaj**.

Deputeti **Bahri Hyseni** i parashtroi pyetje ministres së Drejtësisë lidhur me themelimin e Gjykatës së Qarkut në Ferizaj.

Ministrja **Nekibe Kelmendi** iu përgjigj pyetjes së deputetit **Hyseni**.

Deputetja **Myzejene Selmani** i parashtroi pyetje ministrit të Ekonomisë dhe të Financave lidhur me menaxhmentin e ndërmarrjeve publike.

Ministri **Ahmet Shala** iu përgjigj pyetjes së deputetes **Selmani**.

Deputetja **Luljeta Shehu** i parashtroi pyetje ministrit të Transportit lidhur me rregullimin e rrugëve anësore për ecjen e fëmijëve nëpër rrugët e asfaltuara nëpër fshatra.

Ministri **Fatmir Lima** iu përgjigj pyetjes së deputetes **Shehu**.

Deputetja **Myrvete Pantina** i parashtroi pyetje ministrit të Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë lidhur me plotësimin e kriterëve për licencimin e universiteteve private.

Ministri **Enver Hoxhaj** iu përgjigj pyetjes së deputetes **Pantina**.

Deputetja **Rita Hajzeraj** i parashtroi pyetje ministrit të Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë lidhur me punësimin e arsimtarëve të padiplomuar të gjuhës angleze.

Ministri **Enver Hoxhaj** iu përgjigj pyetjes së deputetes **Hajzeraj**.

Deputeti **Riza Smaka** i parashtroi pyetje ministrit të Transportit lidhur me sinjalizimin dhe vendosjen e shenjave në rrugët publike.

Ministri **Fatmir Lima** iu përgjigj pyetjes së deputeti **Smaka**.

Pyetjet të cilat nuk u parashtruan në këtë seancë për shkak të kohës së kufizuar (50 minuta), procedohen në seancën e radhës.

3. Shqyrtimi i Mocionit për procedimin e ligjeve të pashpallura

Kryetari i njoftoi deputetët se Kryesia e Kuvendit të Kosovës, duke u bazuar në Rregullën 32 dhe 61 të Rregullores së Punës së Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe në Vendimin e Kuvendit të Kosovës, datë 17 korrik 2008, për procedimin e shtatëmbëdhjetë /17/ ligjeve të pashpallura për rishqyrtim në komisione parlamentare, i ka propozuar seancës plenare që të marrë vendim për procedimin e ligjeve të pashpallura sipas tekstit të mocionit që u është shpërndarë deputetëve.

Ai kërkoi deklarimin e kryetarëve të grupeve parlamentare lidhur me këtë propozim.

Kryetarët e grupeve parlamentare të PDK-së, të LDK-së, të AAK-së, të LDD-së, të SLS-së dhe “7+” deklaruan se mbështesin mocionin e propozuar.

Kryetari i Grupit Parlamentar të AKR-së, Ibrahim Makolli, kërkoi që deputetëve t’u mundësohet të diskutojnë gjatë rishqyrtimit të këtyre ligjeve.

Deputetët Riza Smaka dhe Mahir Yagcilar propozuan që këto ligje të procedohen në dy lexime.

Kryetari hodhi në votim mocionin e propozuar. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----51;
Kundër----- 9;
Abstenime----- 2.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, mori këtë

V E N D I M

Për procedimin e shtatëmbëdhjetë (17) ligjeve të pashpallura

1. Kuvendi i Kosovës pajtohet për procedimin e shtatëmbëdhjetë (17) ligjeve të pashpallura, të identifikuara me Vendimin e Kuvendit, të datës 17 korrik 2008, sipas procedurës, në vijim:

- 1.1 Komisioni përgjegjës raportues (funksional) i caktuar me Vendimin e Kuvendit, të datës 17 korrik 2008, rishqyrton tekstin e Ligjit të pashpallur dhe në afatin e paraparë Kuvendit i paraqet Rekomandimet me amendamentet e propozuara për shqyrtim dhe miratim.
- 1.2 Rekomandimet për amendamente lidhur me implikimet eventuale buxhetore, duhet paraprakisht të shqyrtohen nga Komisioni për Buxhet dhe Financa.
- 1.3 Kuvendi, në seancë plenare shqyrton dhe voton veçmas amendamentet e propozuara nga Komisioni përgjegjës raportues dhe në fund voton tekstin e Ligjit në tërësi, bashkë me amendamentet e miratuara.
- 1.4 Ligji i miratuar evidentohet me numër te veçantë, nënshkruhet nga Kryetari i Kuvendit dhe i dërgohet Presidentit të Republikës së Kosovës për shpallje, në pajtim me nenin 80 të Kushtetutës.

4. Shqyrtimi i Rekomandimit për amendamentimin e Ligjit nr. 02/L-119 për Letërnjoftimin

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Komisioni për Punë të Brendshme dhe Siguri- si komision funksional dhe raportues- në bazë të Vendimit të Kuvendit, datë 17 korrik 2008, ka rishqyrtuar tekstin e Ligjit për letërnjoftim dhe në afatin e paraparë Kuvendit ia ka paraqitur Raportin me rekomandime.

Ai ftoi kryetarin e Komisionit për Punë të Brendshme dhe Siguri që para deputeteve ta arsyetojë raportin.

Kryetari i Komisionit **Rrustem Mustafa** tha se komisioni funksional ka rishqyrtuar Ligjin për letërnjoftim dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime, për miratim.

Përveç amendamenteve të përfshira në këtë raport, kanë ardhur edhe tri amendamente nga Ministria e Punëve të Brendshme, të cilat i kemi shqyrtuar dhe i mbështesim.

Në emër të Komisionit propozoi që amendamenti numër 7 të hiqet tërësisht nga raporti dhe të mbetet ashtu siç ka qenë e paraparë me ligj dhe i ftoi të gjithë deputetët që ta miratojnë raportin e Komisionit për Punë të Brendshme dhe Siguri.

Kryesuesi i hodhi në votim, veç e veç, amendamentet e Komisionit për Punë të Brendshme dhe Siguri dhe të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Kuvendi miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20 dhe 21.

Më pastaj, kryesuesi e hodhi në votim tekstin e ligjit me amendamentet e miratuara. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----72;

Kundër----- 0;

Abstenime----- 0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi njëzëri miratoi Ligjin për letërnjoftimin.

5 Shqyrtimi i Rekomandimit për amendamentimin e Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2003/9 për kooperativat e bujqve

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe planifikim Hapësinor - si komision funksional dhe raportues - në bazë të Vendimit të Kuvendit, datë 17 korrik 2008, ka rishqyrtuar tekstin e Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin të Ligjit nr. 2003/9 për kooperativat e bujqve dhe në afatin e paraparë Kuvendit ia ka paraqitur Raportin me rekomandime.

Ai ftoi kryetarin e komisionit funksional ta arsyetojë raportin para deputetëve.

Kryetari i Komisionit për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, **Lulzim Zeneli**, tha se komisioni funksional ka rishqyrtuar tekstin e Ligjit dhe Kuvendi\ t ia ka paraqitur raportin me rekomandime dhe i ftoi deputetët që t'i miratojnë amendamentet e propozuara.

Kryesuesi i hodhi në votim, veç e veç, amendamentet e Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor.

Kuvendi miratoi amendamentet: 1, dhe 2.

Kryesuesi e hodhi në votim tekstin e ligjit, me amendamentet e miratuara. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----76;

Kundër-----0;

Abstenime----- 2.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash miratoi Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2003/9 për kooperativat e bujqve.

6. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor lidhur me gjendjen në parkun nacional “Malet e Sharrit” dhe në “Fshatin Turistik” në Prevallë

Kryesuesi tha se Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor ka shqyrtuar aktivitetet e zhvilluara në parkun nacional “Malet e Sharrit” dhe Kuvendit i ka parashtruar Raportin me rekomandime.

Ai ftoi kryetarin e komisionit funksional që ta paraqet Raportin para deputetëve.

Lulzim Zeneli tha se komisioni funksional parlamentar aktivitetin dhe vizitat i ka filluar pas marrjes së letrës nga Avokati i Popullit, të cilën letër Kuvendit ia ka adresuar më 6 qershor 2008 për gjendjen në parkun nacional “Malet e Sharrit”, për shkatërrimet ilegale të resurseve natyrore, punimet e gurëthyesve dhe ndërtimet ilegale të objekteve private.

Pas vizitave që komisioni i ka pasur në Kuvendin Komunal të Prizrenit dhe në parkun nacional, jemi njoftuar për së afërmi me shkeljet që po ndodhin atje, të cilat shkelje janë në kundërshtim me Ligjin për Planifikimin Hapësinor dhe Ligjin për Mbrojtjen e Natyrës.

Këto shkelje, shkatërrimi i vlerave natyrore, ndërtimet e objekteve ilegale dhe ato të gurëthyesve janë në kundërshtim me parimet themelore të ligjeve në fuqi.

Plani rregullativ për fshatin Prevallë nuk ka mundësi të hartohet dhe të aprovohet pa ekzistimin e planit hapësinor për mbrojtjen dhe zhvillimin e parkut nacional konform Ligjit për parkun nacional “Malet e Sharrit”, Ligjin mbi mbrojtjen e natyrës, Ligjin për planifikimin hapësinor dhe Ligjin për ndërtimin.

Meqë me Planin urbanistik të fshatit Prevallë janë bërë shkelje edhe të Kodit të përkohshëm penal të Kosovës, kërkesa e tij ishte që të ndërpriten urgjentisht të gjitha aktivitetet në zonën e parkut nacional “Malet e Sharrit”, duke përfshirë këtu edhe prerjen ilegale të pyjeve.

Ai propozoi që Qeveria – Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor ta shqyrtojë gjendjen e krijuar në parkun nacional dhe ta informojë Kuvendin për dëmet e shkaktuara atje, duke theksuar që brenda 6 muajve Ministria në fjalë të hartojë planin operacional dhe të ndajë një buxhet për sanimin e gjendjes në terren.

Kryesuesi hapi debatin lidhur me Raportin e Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor.

Berat Luzha – në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës tha se parku nacional, me sipërfaqe prej 39.000 hektarë, sipas Ligjit për parkun nacional “Malet e Sharrit”, të vitit 1986, ka filluar të funksionojë nga viti 1995.

Në vitin 2002 është formuar Drejtoria legale me seli në Prizren në kuadër të Ministrisë së Mjedisit, mirëpo parku është i ndarë në dysh dhe tani udhëhiqet nga dy drejtori paralele, pasi që pas luftës Drejtoria e parkut në Shtërpçë është uzurpuar nga strukturat paralele të lidhura me Serbinë.

Plani i përkohshëm rregullues urban për zonën e Prevallës, i hartuar nga kuvendi komunal dhe i miratuar në vitin 2006 nga Ministria e Mjedisit, pas fillimit të ndërtimeve ka marrë pëlqimin, i cili i është dhënë komunës me kusht që atje të respektohen ligjet në fuqi. Mbi këtë bazë, këto dokumente janë pa mbështetje të duhur ligjore, aq më tepër që vet Ministria ka lejuar të bëhen ndërtime nga një subjekt tjetër, të cilat ka qenë e obliguar t’i menaxhonte vet.

Në Prevallë po bëhet një biznes i llojit të vet në dëm të zonës së mbrojtur me ligj.

Është për t'u theksuar se parku nacional "Malet e Sharrit" edhe pas 22 vjetëve nuk ka plan hapësinor, ndërsa tani atje, nga 360 shtëpi të planifikuara, vetëm 36 prej tyre janë të pajisura me leje ndërtimi e që edhe ato leje janë kontestuese pasi që lejet janë dhënë që shtëpizat të ndërtohen me sipërfaqe prej 50 deri 70 m² dhe atë prej materialit të drurit, ndërsa gjendja reale është se shtëpizat atje janë të ndërtuara deri në 300 m², dy – tri katëshe dhe prej materialit të fortë. Qeveria ia procedon Kuvendit për miratim përfundimtar të gjitha planet rregulluese në parqet nacionale, parkun nacional e shpall Kuvendi i Kosovës sipas ligjeve në fuqi.

Kërkesa e tij, në emër të grupit parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, ishte që të ndërpriten të gjitha aktivitetet ndërtimore në Prevallë dhe të formohet një komision hetimor i Kuvendit të Republikës së Kosovës, i cili do të studionte gjendjen atje dhe në afat prej 3 muajve të sjellë rekomandimet e duhura në Kuvend.

Lutfi Haziri – në emër të grupit parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, meqë kemi të bëjmë me një vendim apo rekomandim të komisionit funksional, që përveç Parlamentit e obligon edhe Qeverinë, kërkoi që të jetë prezent edhe Kryeministri.

Grupi ynë parlamentar çmon punën e komisionit funksional, gjithashtu çmon rolin e çdo komisioni dhe deputeti në monitorimin e ligjit dhe zbatimin e tij, por pas sqarimeve të dhëna nga Kryetari i Komisioni për Bujqësi, kuptohet se nuk kemi të bëjmë me monitorime për moszbatueshmëri të ligjit, por me tendenca të motivuara, për të cilat ai dha sqarime:

- Për Grupin Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës zbatimi i ligjit është obligim i çdokujt dhe secili në bazë të kapacitetit që ka duhet ta marrë mbi vete.
- Materiali i ofruar për rekomandimin në fjalë nuk ka ofruar prova të domosdoshme për një rekomandim final për faktin se nuk janë ofruar dokumente bazike, mungesa e të cilave na bënë që të jemi më pak të informuar.
- Me Kushtetutën e Kosovës, të drejtat e asambleve komunale janë të ndara, që as Parlamenti nuk ka të drejtë të ndërhyjë në planifikimin rural dhe urban të asambleve komunale. Vlen për t'u theksuar se vetëm kur asambleja komunale dështon, ka të drejtë të ndërhyjë ministria përkatëse për ushtrimin e të drejtës.
- Bordi i drejtorëve i Asamblesë Komunale të Prizrenit me një vendim të paligjshëm ka dalë mbi asamblenë komunale me ndalimin e punimeve në Prevallë, ngase asambleja komunale në komunat e Kosovës është organ vendimmarrës, dhe në kontekst të kësaj rekomandimi i parë është i paqëndrueshëm.
- Detyrat që komisioni ia jep Qeverisë për sanimin e gjendjes, nuk janë detyra të komisionit.

Heset Cakolli – në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së – duke i mbështetur diskutimet e parafolësve, ai tha se i mbetet Qeverisë të pengojë të gjitha aktivitetet e kundërligjshme, nëse ato ekzistojnë atje, në kuadër të hapësirës së parkut nacional.

Në emër të grupit parlamentar, mbështeti propozimet e komisionit funksional për 4 pika të veçanta që i janë dërguar Qeverisë.

Ardian Gjini - në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së – shpalosi disa dilema duke theksuar se ka një obligim t'i japë disa shpjegime me arsyetimin se vendimet janë marrë në kohën kur ai ka qenë ministër i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Duke e mbështetur diskutimin e z. Haziri, tha se nëse Komisioni parlamentar për Bujqësi në rekomandim konstaton se është shkelur ligji, pse nuk është sjellë vendimi dhe pse nuk iu kanë bashkangjitur edhe dokumente të tjera materialit.

Është shumë indikative që në rekomandim janë bërë bashkë çështje të ndryshme, prerja ilegale e pyjeve, shfrytëzimi i zhavorrit nga gurëthyesit, që janë dy veprimtari ilegale, me një veprimtari e cila është legale – ndërtimi i kampshtëpizave.

Lidhur me këtë, Grupi Parlamentar i AAK-së mendon se këto janë çështje të ndara për të cilat duhet të diskutohet ndarazi.

Naser Rugova - në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së – duke cituar dispozitat ligjore të Ligjit për mbrojtjen e natyrës, sipas të cilave dispozita në fuqi “Parku nacional shpallet nga Kuvendi i Kosovës” dhe pas nxjerrjes së aktit për shpalljen e zonës së mbrojtur të natyrës nxirret plani i posaçëm i menaxhimit për secilën zonë nga organi që e ka vënë atë nën mbrojtje. Kuvendi Komunal i Prizrenit nuk ka pasur asnjë të drejtë ligjore të fillojë hapa të planit urbanistik pa ekzistuar plani i rregullimit hapësinor.

Shkresa e OSBE-së është në përputhje të plotë me vërejtjet e Ombudsperson –it. Raporti i Drejtorisë për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor të Komunës së Prizrenit vë në pah shkelje flagrante edhe të ligjeve, edhe të procedurave, edhe të lejeve të ndërtimit, edhe të planit urbanistik.

Derisa bota po shkon kah globalizimi dhe po investon mjete të konsiderueshme për mbrojtjen e mjedisit jetësor, ambientit, në programin tonë qeveritar ne kemi vetëm gjysmë faqe për mjedis dhe planifikim hapësinor.

Ai citoi një pjesë të programit të Qeverisë ku thuhet: “Qeveria do të inkurajojë zhvillimin e fushatave të ndërgjegjësimit me qëllim të mbrojtjes së mjedisit”. “Ruajtja dhe menaxhimi efikas i zonave të mbrojtura, me vlera të larta të biodiversitetit, rezervatet strikte, parqet kombëtare e të tjera”.

Duke u ditur kushtet, kriteret dhe specifikat e parkut nacional “Malet e Sharrit” shkatërrimi i pasurive natyrore në “Fshatin Turistik” në Prevallë është shembull i degradimit të mjedisit.

Në fund të kësaj, dikush është përgjegjës, ata dihen. Përveç që kanë adresë të subjekteve politike, ata kanë edhe emër e mbiemër.

Bojan Stojanović - shefi i Grupit SLS – Grupi ynë parlamentar mbështet rekomandimet e komisionit, duke i dëgjuar parafolësit të cilët konsiderojnë që nuk është mirë të ndërmerren të gjitha masat të cilat kanë të bëjnë me parkun nacional, aq më tepër po bindem që kjo urgjentisht duhet të bëhet. Propozimet që masat duhet të ndërmerren, 6 – 9 muaj janë një periudhë mjaft e gjatë për dikë që atje ndërton.

Të gjithë ata qytetarë që kanë kaluar në Prevallë dhe kanë parë se çka po ndodhë atje, kanë fituar një pasqyrë të shkatërrimit të natyrës.

Duke shprehur mendimin e tij, ai tha se dikush këtu do ta humb interesin e tij personal, por interesi personal nuk mund të jetë përtej inetersit të përgjithshëm.

Përsëriti se Grupi i tij parlamentar e përkrah propozimin dhe do të votojë për ndërmarrjen e masave atje.

Xhezair Murati - në emër të Grupit Parlamentar” 7+” – duke falënderuar Komisionin për Bujqësi dhe duke përkrahur Ombudsperson-in për iniciimin që kjo çështje sot të debatohet në Kuvend, ai tha se me vendimin për ndërtimet në “Ffshatin Turistik” në Prevallë janë shkelur të gjitha ligjet të cilat e rregullojnë këtë sferë dhe konventat ndërkombëtare.

Ne duhet të pranojmë se janë bërë gabime atje, ndoshta nuk kanë qenë të qëllimshme, por dikush nga ne sot këtu duhet të tregojë se si të tërhiqemi nga këto gabime.

Ndërtimi i 360 objekteve në Prevallë është shkatërrim i 17 hektarëve tokë, që nuk është një sipërfaqe e vogël për Kosovën. Me planet urbanistike në Prevallë po shkatërrohet flora dhe fauna dhe rëndësia e natyrës malore.

Ne jemi duke jetuar në kohën kur e tërë bota ka ndezur dritën e kuqe për mbrojtjen e natyrës. Duke pasur parasysh që parku nacional “Malet e Sharrit” shtrihet në disa komuna dhe është në kompetencë të Qeverisë dhe të Kuvendit të Kosovës, nuk mundet që një komunë para të tjerave të bëjë diçka.

Ne mund të arsyetohemi dhe të mbrohemi secili qysh mundet dhe di, por nuk mundet dikush të dëshmojë që në Prevallë nuk ka shkatërrim.

Në fund, ai tha se Grupi parlamentar, duke përkrahur rekomandimin e komisionit, pret nga Qeveria dhe Kuvendi që bashkë ta kuptojnë seriozitetin e kësaj, duke apeluar që të gjithë ta kuptojnë kështu problemin.

Mahir Yagcilar - Ministër i Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor – Aktivitetet në “Fshatin turistik” në Prevallë kanë filluar pasi Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, pas aprovimit të kërkesës së Kuvendit Komunal të Prizrenit për planin rregullativ të Prevallës, ka marrë vendim me datë 4 shtator 2006 për të dhënë pëlqimin sipas kushteve të parapara me ligjet në fuqi.

Atje janë dhënë 38 leje ndërtimore nga Kuvendi Komunal i Prizrenit, për të cilat leje Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor ka formuar një grup punues për vlerësimin e gjendjes faktike në terren. Në raportin e grupit punues thuhet se ndërtimet posedojnë leje, mirëpo nuk janë respektuar kriteret e dhëna me leje dhe plan rregullues dhe kjo është arsyeja e ndërprerjes së dhënies së lejeve për ndërtim.

Më 25 qershor 2008, Drejtoria e Urbanizimit dhe Planifikimit Hapësinor të Prizrenit, me një kërkesë iu ka drejtuar Ministrisë për revidimin e planit të përkohshëm rregullues urban të zonës së Prevallës. Ministria e Mjedisit dhe e Planifikimit Hapësinor, respektivisht Departamenti për Planifikim Hapësinor dhe Instituti i Planifikimit Hapësinor janë duke punuar në hartimin e planit hapësinor për zonën e veçantë parku nacional “Malet e Sharrit”, kështu që deri sa ta përfundojë punën, Grupi për hartimin e planit hapësinor nuk do të marrë kurrfarë vendimi. Në Bordin e drejtorëve të Kuvendit të Komunës së Prizrenit është marrë vendim për rishikimin apo revidimin e planit rregullues ekzistues dhe ndërrimin e emërimit të “Fshatit Turistik” në Prevallë dhe ky vendim pritet të miratohet në asamblenë komunale.

Arsyet për revidimin e këtij plani janë koeficienti i lartë i ndërtimit dhe numri i madh i shtëpive të parapara me planin ekzistues, që rezulton se është jashtë rregullave dhe kriterëve që i përkasin një zone të shpallur park nacional.

Prandaj, do të formohet grupi punues i përbërë nga ekspertët e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe të Kuvendit Komunal të Prizrenit për të shqyrtuar mundësinë për marrjen e një vendimi të përbashkët për revidim të projektit, si dhe do të shqyrtohen të gjitha modalitetet e mundshme, duke iu referuar dispozitave që dalin nga ligjet ekzistuese.

Pas deklarimit të kryetarëve - përfaqësuesve të grupeve parlamentare, Kryetari ua dha fjalën deputetëve të paraqitur për debat.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë temë dhanë edhe këta deputetë: **Xhavit Haliti, Emrush Xhemajli, Naim Rustemi, Numan Baliq, Zafir Berisha, Ardian Gjini, Lutfi Haziri, Lulzim Zeneli, Edita Tahiri, Bahri Hyseni, Riza Smaka, Naim Maloku dhe Eqrem Kryeziu.**

Diskutimet e plota të deputetëve janë pjesë përbërëse e transkriptit të kësaj seance.

Ramë Buja, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së propozoi që debati i sotëm të ndërpritet dhe të vazhdojë javën e ardhshme, me plotësimin e dokumenteve të domosdoshme, më qëllim që të informohen të gjithë deputetët.

Lutfi Haziri tha se Grupi Parlamentar i LDK-së e mbështet propozimin e shefit të Grupit Parlamentar të PDK-së. Janë 4 dokumente që i kam përmendur në fjalën time hyrëse si mungesa e dosjes së paraqitur nga ana e Komisionit. Dokumenti i 5-të ka të bëjë me vendimin e Bordit të drejtorëve për suspendimin dhe këto dokumente janë të domosdoshme për ta qartësuar votimin e çdo deputeti.

Ibrahim Makolli, tha se edhe Grupi Parlamentar i AKR-së e përkrah kërkesën që të shtyhet ky debat dhe të vazhdojë javën e ardhshme në një seancë të rregullt.

Ardian Gjini, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, tha se mbështesim propozimin për shtyrje, por duhet të plotësohet dokumentacioni i deputetëve me dokumentet që nuk i kemi marrë nga Komisioni parlamentar.

Lulzim Zeneli, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, tha se e kuptoj sa është vështirë që një grup parlamentar t'i përmbahet presionit të tillë. Kjo seancë plenare mund të marrë çfarëdo vendimi, por asnjëherë nuk mund ta justifikojë shkeljen e tri ligjeve themelore të kësaj natyre.

Sadik Idriz, në emër të Grupit Parlamentar "7+", tha se gjendja e sotme në Prevallë është e tmerrshme, kështu që asnjë argument për shqyrtim të mëvonshëm të saj nuk do ta përmirësojë atë.

Kryetari hodhi në votim propozimin e kryetarit të Grupit Parlamentar të PDK-së. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----57;

Kundër-----16;

Abstenime----- 2.

Kryetari konstatoi se Kuvendi miratoi mocionin procedural për ta shtyrë debatin, me qëllim të kompletimit të materialit të nevojshëm për deputetë, për ta vazhduar në seancë tjetër.

E premte, më 10 tetor 2008, ora 10:00

Vazhdimi i seancës

Seancën e drejtoi Jakup Krasniqi, Kryetar i Kuvendit, ndërsa i ndihmuan Ibrahim Gashi dhe Xhavit Haliti, anëtarë të Kryesisë së Kuvendit.

Kryetari konstatoi se në seancë janë të pranishëm 78 deputetë dhe e deklaroi të hapur punën e saj.

Në fillim të seancës, Kryetari, në emër të Kuvendit përshëndeti vendimin e Qeverisë së Malit të Zi dhe vendimin e Qeverisë së Maqedonisë për njohjen e pavarësisë së Republikës së Kosovës.

Lutfi Haziri, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, paraqiti mocion për heqjen e pikës së 6-të të rendit të ditës, me arsyetimin se sekretari i Kuvendit, në bazë të përfundimit të seancës plenare të 3 tetorit 2008, ka proceduar vetëm dy dokumente të rëndësishme për deputetët, por mungojnë edhe një numër i madh i dokumenteve që janë kërkuar: Plani i përkohshëm rregullativ dhe vendime të tjera, që e kanë përcjellë këtë problematikë deri në këtë fazë, kështu që nuk është e nevojshme që për këtë çështje të debatohet.

Kryetari kërkoi deklarimin e grupeve parlamentare lidhur me mocionin e Grupit Parlamentar të LDK-së.

Kryetarët e grupeve parlamentare të PDK-së dhe të AAK-së deklaruan se e mbështesin mocionin e Grupit Parlamentar të LDK-së, ndërsa ata të AKR-së, të LDD-së dhe "7+" deklaruan se nuk e mbështesin mocionin e Grupit Parlamentar të LDK-së, kurse ai i SLS-së deklaroi se abstenon.

Kryetari hodhi në votim mocionin e Grupit Parlamentar të LDK-së. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 45;

Kundër----- 23;

Abstenime----- 6.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash miratoi mocionin e kryetarit të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës që pika e 6-të - Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor lidhur me gjendjen në parkun nacional “ Malet e Sharrit” dhe në “Fshatin Turistik” në Prevallë - të hiqet nga rendit të ditës.

Ramadan Gashi, në emër të Komisionit Ad - hoc propozoi që në rend dite të kësaj seance të përfshihet edhe shqyrtimi i parë i Projektligjit për pensionet e pjesëtarëve të Trupave Mbrojtëse të Kosovës.

Kryetari kërkoi deklarinimin e grupeve parlamentare lidhur me propozimin e deputetit Ramadan Gashi.

Kryetarët e të gjitha grupeve parlamentare deklaruan se e mbështesin propozimin e deputetit Ramadan Gashi, përveç kryetarit të Grupit Parlamentar të SLS-së, i cili tha se abstenojnë.

Kryetari hodhi në votim këtë propozim. Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për-----65;

Kundër----- 6

Abstenime----- 8.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash vendosi që shqyrtimi i parë i Projektligjit për pensionet e pjesëtarëve të Trupave Mbrojtëse të Kosovës të radhitet në rend dite të kësaj seance.

7. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor lidhur me gjendjen në pyjet e Kosovës

Kryetari i njoftoi deputetët se Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor ka shqyrtuar gjendjen aktuale në pyjet e Kosovës dhe Kuvendit ia ka parashtruar raportin me rekomandime.

Ai ftoi kryetarin e Komisionit FunkSIONAL ta paraqesë raportin para deputetëve të Kuvendit.

Lulzim Zeneli, në emër të Komisionit FunkSIONAL tha se Komisioni në kuadër të përgjegjësisë të veta, pas pranimi të ankesave të njëpasnjëshme dhe të shqetësimeve lidhur me gjendjen e rëndë në pyjet e Kosovës, këtë çështje e ka trajtuar me seriozitetin më të madh, duke iu qasur seriozisht procedurës së mbikëqyrjes apo të kontrollit të implementimit të ligjeve në fuqi sa i përket kësaj fushe. Pas vizitave në terren, të realizuara në Kuvendin Komunal të Deçanit, në një takim të përbashkët me përfaqësues nga Kuvendi Komunal, Shërbimi Policor i Kosovës, Trupat e Mbrojtjes së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur të datës 21.7.2009, shqyrtoi dhe analizoi gjendjen e krijuar në pyjet e Kosovës, e në veçanti në komunën e Deçanit dhe nxori këtë konstatim: “Gjendja e pyjeve në vend, në veçanti në komunën e Deçanit, është tejte e rëndë, duke shkuar drejt një degradimi masiv, si rezultat i

prerjes ilegale të drunjve”, prandaj i propozon Kuvendit të Republikës së Kosovës, të miratojë më sa vijon :

1. Qeveria e Republikës së Kosovës, me vendim duhet t’i ndërpresë përkohësisht të gjitha aktivitetet legale që ndërliken me prerjen e pyjeve në Kosovë, veçanërisht në komunën e Deçanit, duke përfshirë këtu edhe anulimin e tenderëve për prerje të drunjve,

2. Qeveria e Republikës së Kosovës, respektivisht Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural urgjentisht duhet të përgatisë planin menaxhues afatgjatë për pyjet e Kosovës,

3. Qeveria e Republikës së Kosovës duhet të fillojë procedurën për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve: të Ligjit për pyje, të Ligjit nr. 2003/3, në pajtim me politikat e Qeverisë së Kosovës,

4. Qeveria e Republikës së Kosovës duhet të iniciojë procedurën e ristrukturimit të njësive –Rojet e pyjeve, në përputhje me nevojën dhe gjendjen e krijuar në Kosovë.

Xhavit Haliti, në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, pasi përshëndeti Komisionin për çështjen e ngritur, tha se nuk janë vetëm Bjeshkët e Deçanit që janë duke u prerë. Gjithë brezi halor i bjeshkëve të Kosovës dhe gjithë malet me gështenja, aq të domosdoshme për frymëmarrjen dhe mushkëritë e qytetarëve, për bukuritë e Kosovës dhe për zhvillimin e mundshëm dhe të vetëm të mundshëm të turizmit në Kosovë, siç është turizmi malor, janë duke e shkatërruar nga njerëzit e papërgjegjshëm dhe janë duke e shkatërruar për shkak të pamundësisë për t’u mbrojtur ato. Unë po them, sepse e kam parë me sytë e mi, që nga Mokna, Lugu i Butë, Sejnova, Rosulija, Bjeshkët e Rugovës, Bjeshkët e Isniqit, Bjeshkët e Prilepit krejt kjo zonë është duke u dëmtuar pamëshirshëm dhe janë të pambrojtura në tërësi. Me këtë rast do të sugjeroja që Qeveria duhet të marrë një vendim konkret, që përkohësisht të mbrojë me tre rrathë mbrojtjeje, që do të thotë: Drejtoria e Pylltarisë, Policia, por edhe Trupat Mbrojtëse ose Forca e Sigurisë së Kosovës, dhe kjo duhet të bëhet me rotacion. N vazhdim, ai tha se në bjeshkët e Kosovës, në veçanti në Bjeshkët e Nemuna dhe Bjeshkët e Deçanit, të Strellcit, të Isniqit, është një fenomen ku të gjithë ata që dalin në bjeshkë, e kanë shfrytëzuar bjeshkën për kullosa në të kaluarën. Në të kaluarën kanë qenë pronat e tyre, ka pasur gjithmonë konflikte me pushtetin, me njerëzit që kanë dalë pa leje në bjeshkë. Tani ata e konsiderojnë pronë të tyre bjeshkën, por si pronë nuk janë në gjendje ta mbrojnë, andaj edhe Qeveria do të duhej që ta zgjidhte këtë problem me urgjencë, në mënyrë që të definohej prona e kujt është bjeshka, është pronë shoqërore, është pronë e atyre që e shfrytëzojnë për kullosa dhe kush do të japë llogari dhe përgjegjësi për shkatërrimin e saj?

Përndryshe, është tmerr i vërtetë, për ata që kanë ndjenja për pyjet se çfarë është duke ndodhur. Pa e parë në vend, askush nuk e beson. Prandaj, për këtë çështje kërkoj që Ministria përkatëse, Ministria e Bujqësisë, të kërkojë ndihmë ose të vendosë raporte konkrete ose të kërkojë një vendim të veçantë në Qeveri lidhur me çështjet që i ngrita. Përndryshe, ka qenë një vendim i Ministrisë së Bujqësisë për pastrimin pyjeve dhe ai vendim u është dhënë me tender njerëzve të caktuar dhe njerëzve të pandërgjegjshëm, njerëzve të cilët jo vetëm që nuk e kanë pastruar pyllin, por kanë shfrytëzuar këtë favor dhe kanë prerë lëndë drusore më të mirat që i kanë gjetur nëpër pyje dhe i kanë shitur dhe jo që nuk e kanë pastruar, por edhe prerjen e kanë bërë shumë të keqe, që për syrin normal të njeriut është tmerr të shihet se çfarë kanë bërë. Ai mbështeti rekomandimet e Komisionit.

Armend Zemaj, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-se, tha se pavarësisht se kjo çështje me shumë arsye është e vonuar, e përshëndet Komisionin, që më në fund e ka marrë një iniciativë të tillë dhe personalisht ka shkuar në vendin e ngjarjes që të njihet me problematikën në pyjet e atyre trevave.

Edhe përmes pyetjes parlamentare jam munduar që ta ngre këtë çështje se çka po ndodhë me shkatërrimin e këtyre pyjeve në atë trevë, duke përfshirë këtu Bjeshkët e Strellcit, Grykën e Deçanit e deri te Zharet përmbi Botushë.

Atje më nuk ka çka të mbrohet, atje duhet të shikohet që ndoshta të ketë një riprodhim. Pyjet janë totalisht të shkatërruara me vite që nga paralufta dhe nuk po flas që nga paslufta, sepse nga paslufta pyjet, sidomos të Deçanit, kanë qenë të shndërruara në një biznes fitimprurës që, ndoshta, edhe ata që e kanë bërë, nuk e kanë menduar që do ta shkatërrojnë edhe jetën edhe biodiversitetin e tyre. Këtë e them me shumë arsye.

Pronarët e sharrave, me përgjegjësi të plotë do të them, janë të lidhur edhe me pushtetin lokal, por edhe me pushtetin qendror, ndërsa ka qenë problem i madh pengimi i tyre deri më tani. Ne sot duhet të debatojmë për njerëzit që me tenderë të ligjshëm e të paligjshëm, me kamionë të ndryshëm dhe në bashkëpunim edhe me policinë dhe njerëzit e institucioneve kanë shkatërruar pyjet e Deçanit.

Për hir të qytetarëve të asaj treve, duhet të merren masa më radikale. Rojet e pyjeve në Deçan dhe rrethinë janë hajna të malit dhe nuk e di se si do të mbrohen aty pyjet dhe si do të mbrohet ajo natyrë të cilën na e ka dhuruar Zoti.

Ne emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, ne i mbështesim rekomandimet e Komisionit.

Riza Smaka, ne emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, ne fillim të diskutimit tha se mjerisht, nuk është fjala vetëm për pyjet e Deçanit me rrethinë, por për krejt Kosovën, kudo që ka pyje, ato shkatërrohen pamëshirshëm në mënyrën më vandale, tepër të dëmshme për ekokulturën.

Druri si dru, krijon oksigjenin që është burim vital për jetë, prodhon ujë, rezervon ujë, një ah deri në 80 litra, pisha, dru halor, mbi 120 litra ujë, etj. Pra, këto po priten sistematikisht, pa kurrfarë kontrolli, në mënyrën më vandale. Natyrisht, përpos tjerash, po shterin gurrat, burimet e ujërave. Ne duhet të angazhojmë policinë pyjore të veprojë sipas ligjit, që do të thotë, policë, me edukatë për pyllin, që dinë rëndësinë e pyllit. Përderisa nuk e bëjmë këtë, e kjo mendoj se është çështje shumë e ngutshme, duhet me një dokument juridik ta autorizojmë, ta obligojmë policinë tonë civile publike që të ketë autorizime dhe obligime për të ndërmarrë masa kundër uzurpatorëve, abuzuesve, plaçkitësve të pyjeve tona. Mbështes rekomandimet e Komisionit.

Ibrahim Selmanaj, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, tha se sot po debatojmë për një temë të ndjeshme siç janë pyjet e Kosovës dhe më ka rastisur që Komisioni Parlamentar me insistimin që ka pasur Kuvendi Komunal i Deçanit, të bëjë një vizitë edhe ta shohim drejtpërsëdrejti se çka ka ndodhur dhe çka zhvillohet në atë trevë?

Realisht, në kompleksin e përgjithshëm në Deçan janë përafërsisht 19.000 hektarë pyje, që në përgjithësi janë 4% të pyjeve të Kosovës. Prerja e drurit në Deçan bëhet përafërsisht 20% të masës së paraparë brenda vitit për shfrytëzim. E kam lutur ministrin që me një udhëzim administrativ të ndërmarrë masa dhe të mos ketë më prerje të drurit.

Në këtë rast, përpos rekomandimeve që dalin nga kuvendi komunal, në pajtueshmëri të plotë edhe me Komisionin parlamentar, unë shoh edhe një zhvillim negativ që bëhet tash në këtë mes e që është rajonalizimi.

Ne vazhdim, ai tha se problem tjetër janë gjykatat, të cilat nuk marrin masa adekuate për keqbërësit dhe keqpërdoruesit dhe, prapë, çështje tjetër janë rojet e pyjeve, të cilat nuk kanë siguri. I vetmi autoritet që e ka trajtuar çështjen seriozisht në mbrojtje të pyjeve është Policia e Kosovës.

Ministria e Bujqësisë dhe e Pylltarisë, në bashkëpunim me autoritetin pyjor, duhet ta bëjë pastrimin e pyjeve në formën më të mirë, duke i shfrytëzuar të gjitha hapësirat edhe papunësinë që është mjaft e lartë në Kosovë. Në të njëjtën kohë, duhet t'u krijohet edhe një mundësi më e lehtë qytetarëve që përmes pastrimit të pyjeve, përmes drurit të thatë, edhe ata ta shfrytëzojnë drurin me çmim më të përshtatshëm, me çmim më të favorshëm. Në të njëjtën kohë, edhe një mundësi tjetër, që me ato mjete të cilat grumbullohen, të bëhet ripyllëzimi. Mbështes rekomandimet e Komisionit.

Naser Rugova, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, ne fillim tha se më në fund, po diskutojmë për një çështje shumë të rëndësishme për qytetarët e Kosovës, për mbrojtjen e pyjeve të vendit tonë që është e garantuar edhe me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Gjendja aktuale në pyjet e Kosovës është më tepër se shqetësuese, me tendencë të eskalimit në katastrofë ekologjike dhe që, fatkeqësisht, këta trendë po vazhdojnë me dijen dhe pëlqimin e atyre që ligji dhe Kushtetuta i obligojnë t'i mbrojnë ato.

Pajtohemi plotësisht me rekomandimin e Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, i cili konstaton shkatërrimin dhe degradimin e pyjeve në regionin e Rrafshit të Dukagjinit, me theks të veçantë në komunën e Deçanit. Për ne, si Grup Parlamentar, por edhe për qytetarët e Kosovës, kjo gjendje është e papranueshme dhe vazhdon të mbetet brengë heshtja e vazhdueshme e institucioneve kompetente që nënkupton miratimin dhe vazhdimin e degradimit dhe të prerjes ilegale të pyjeve të Kosovës nga ana e keqbërësve. Pasojat e këtyre veprimeve, apo më mirë të them, të mosveprimeve të institucioneve kompetente që keqbërësit të ndalohen, do të jenë të mëdha për brezat e rinj të Kosovës, të cilëve po iu shkatërrohet pa të drejtë, në mënyrë të pamëshirshme, pasuria kombëtare dhe mjedisi jetësor.

Shkatërrimi i pasurive kombëtare, të pyjeve të vendit tonë, në të cilat ndodhen vendet më të bukura turistike të Kosovës, siç janë: Bjeshkët e Deçanit, Bjeshkët e Rugovës dhe Bjeshkët e Istogut, është i pafalshëm dhe është i dënueshëm.

Ne, si Grup Parlamentar, përkrahim rekomandimet e Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor që duhen masa preventive emergjente, sepse edhe ashtu jemi shumë vonë.

Xhezair Murati, në emër të Grupit Parlamentar "7+", tha se komisioni funksional ka ngritur një çështje që jo vetëm se rrezikon interesat e qytetarëve, por çrregullon edhe baraspeshën biologjike, njësoj si rasti i Prevallës. Pyjet janë mushkëritë e njeriut. Ne vendet me sistem të zhvilluar të mbrojtjes së mjedisit, prerja e pyjeve është vepër penale që dënohet me ligj. Gjithashtu, edhe prerja sanitare e pyjeve bëhet nën përkujdesje të ekspertëve pyjorë. Pastaj, ai foli për pasojat që shkaktojnë prerjet e pakontrolluara të pyjeve. Ne vazhdim, deputeti Murati foli për rastin e protestës së qytetarëve të fshatit Nebregoshte dhe për sjelljen jo korrekte të disa zyrtarëve.

Grupi Parlamentar "7+" i mbështet në tërësi rekomandimet e Komisionit për Bujqësi e Pylltari, që në mënyrë institucionale të mbrohen pyjet e Kosovës.

Pas deklarimit të kryetarëve apo të përfaqësuesve të grupeve parlamentare, kryetari ua dha fjalën deputetëve të paraqitur për debat.

Opinionet, vërejte dhe propozimet paraqitën deputetët: **Heset Cakolli, Sanije Aliaj, Elheme Hetemi, Hydajet Hyseni, Gjylnaze Sylaj, Safete Hadergjonaj, Shkumbin Demaliaj, Berat Luzha, Rasim Selmanaj, Ibrahim Makolli, Mark Krasniqi, Vezira Emrush, Naim Maloku, Gani Geci, Berim Ramosaj, Myrvete Pantina, Driton Tali, Ramadan Avdiu, Bahri Hyseni, Emrush Xhemajli, Nurishahe Hulaj, Hajdin Abazi dhe Ardian Gjini.**

Diskutimet e plota të deputeteve janë pjesë përbërëse e transkriptit të kësaj seance.

Në përfundim të debatit diskutoi edhe ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, z. **Idriz Vehapi.**

Kryetari i Komisionit z. **Lulzim Zeneli**, propozoi që para se të votohet, Komisioni të tërhiqet për 15 minuta, për t'i plotësuar rekomandimet.

Kryesuesi i seancës, z. **Xhavit Haliti**, propozoj që votimi i rekomandimeve të Komisionit për këtë çështje të shtyhet për seancën e parë të radhës, me qëllim që të inkorporohen edhe rekomandimet shtesë nga debati i sotëm.

Propozimi u miratua njëzëri. Kuvendi vendosi që votimi i rekomandimeve të Komisionit lidhur me gjendjen në pyjet e Kosovës, të shtyhet për seancën e parë të radhës, me qëllim që të inkorporohen edhe rekomandimet shtesë nga debati i sotëm.

8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për pensionet e pjesëtarëve të Trupave Mbrojtëse të Kosovës

Kryetari ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që ta prezantojë Projektligjin para deputetëve të Kuvendit.

Ministri i Forcës së Sigurisë, Fehmi Mujota, tha se ky projektligj është njëri prej ligjeve që parashihet Pakoja e Presidentit Ahtisari dhe është në harmoni të plotë me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe Ligjin për shpërbërjen e Trupave Mbrojtëse të Kosovës.

Projektligji rregullon të drejtën për pension të gjithë pjesëtarëve aktivë të Trupave Mbrojtëse të Kosovës, të cilët nuk do të përfshihen në Forcën e Sigurisë së Kosovës, si dhe të drejtën e trashëgimtarëve të pensionit, bashkë me përfitime të tjera sipas ligjit.

Projektligji përmban gjithsej 4 kapituj, me 30 nene, si dhe dispozitat përfundimtare dhe kalimtare.

Pensionet, nga ky projektligj i përfitojnë tri kategori.

Pensionin e parakohshëm mund ta gëzojnë pjesëtarët e Trupave Mbrojtëse të Kosovës kur të kenë arritur moshën prej 45 vjeç.

Pensionin e përgjithshëm mund ta gëzojnë pjesëtarët e Trupave Mbrojtëse të Kosovës kur të kenë arritur moshën 50 vjeç.

Pensionin e trashëgimtarëve, përkatësisht pensionin e bashkëshortit dhe pensionin i fëmijëve trashëgimtarë, në rast të vdekjes së përfituesit të pensionit, e rregullon neni 14.

Shuma e pensioneve sipas këtyre kategorive është:

- Pensionin e parakohshëm, përfituesit do ta marrin në lartësinë 50% të pagës mesatare që kanë marrë në 3 vjetët e fundit në shërbim në Trupat Mbrojtëse të Kosovës.
- Pensionin e përgjithshëm, përfituesit do ta marrin në lartësinë 70% të pagës mesatare që kanë marrë në 3 vjetët e fundit në shërbim në Trupat Mbrojtëse të Kosovës.
- Pensionin e trashëgimtarëve, gjegjësisht të bashkëshortit ose të bashkëshortes përfituese, do ta realizojnë në lartësinë 60% të pensionit që ka marrë pensionisti para vdekjes.
- Pensioni i fëmijëve trashëgimtarë, që e gëzojnë fëmijët pa prindër, në lartësi prej 20% të shumës që ka realizuar pensionisti para vdekjes.

Përfitime shtesë, sipas këtij projektligji, është e drejta e shfrytëzimit të pensionit edhe në rast se përfituesit e këtij pensioni krijojnë marrëdhënie pune, qoftë në sektorin privat apo publik.

Ministria e Punës është përgjegjëse për administrimin e pensioneve, të cilat realizohen pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Kryetari hapi debatin për shqyrtimin e këtij projektligji, në parim.

Në emër të **Komisionit Ad Hoc, Ramadan Gashi**, tha se Komisioni, në pajtim me vendimin e Kuvendit të Kosovës, datë 15 shkurt 2008, për shqyrtimin e projektligjeve sipas procedurës së veçantë nga Propozimi gjithëpërfshirës i Marti Ahtisarit për zgjidhjen e statusit të Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 9 tetor 2008, shqyrtoi Projektligjin për pensionet e pjesëtarëve të Trupave Mbrojtëse të Kosovës, të propozuar nga Qeveria dhe hartoi raportin preliminar, me të cilin vlerësohet se ky projektligj i plotëson kriteret formale-juridike, të parapara për procedimin e projektligjeve dhe i propozon Kuvendit që ta miratojë, në parim.

Kryetari i Grupit Parlamentar të PDK-së, Ramë Buja, deklaroi se mbështesin në parim Projektligjin për pensionet e pjesëtarëve të Trupave Mbrojtëse të Kosovës.

Deputeti **Haki Shatri**, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, deklaroi se mbështesin në parim Projektligjin për pensionet e pjesëtarëve të Trupave Mbrojtëse të Kosovës.

Kryetari i Grupit Parlamentar të AKR-së, **Ibrahim Makolli** tha se e përkrahin në parim Projektligjin për pensionet e pjesëtarëve të Trupave Mbrojtëse të Kosovës.

Kryetari i Grupit Parlamentar të AAK-së, **Ardian Gjini** tha se mbështesin në parim Projektligjin për pensionet e pjesëtarëve të Trupave Mbrojtëse të Kosovës.

Deputeti **Gani Geci**, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së deklaroi se mbështesin në parim Projektligjin për pensionet e pjesëtarëve të Trupave Mbrojtëse të Kosovës.

Deputeti **Sadik Idriz**, në emër të Grupit Parlamentar “7+” deklaroi se mbështesin në parim Projektligjin për pensionet e pjesëtarëve të Trupave Mbrojtëse të Kosovës.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari hodhi në votim Projektligjin për pensionet e pjesëtarëve të Trupave Mbrojtëse të Kosovës. Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për-----58;
Kundër----- 1;
Abstenime----- 0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për pensionet e pjesëtarëve të Trupave Mbrojtëse të Kosovës.

Kuvendi, në bazë të vendimit të datës 15 shkurt 2008, ngarkoi Komisioni Ad-Hoc, që ta shqyrtojë këtë projektligj dhe Kuvendit t’ia paraqesë raportin me rekomandime për seancën e radhës.

Kryetari e deklaroi të mbyllur seancën në orën 15:10 minuta.

Kryetari i Kuvendit
Jakup KRASNIQI

Përgatiti:
Divizioni i Çështjeve Plenare dhe Procedurale